

Si ta trajtojmë Ballkanin Perëndimor?

*Anton Bebler**

Përmbledhje

Me përfundimin e shekullit të kaluar, një qetësi e jashtme u imponua në Ballkanin Perëndimor, rajonin më të paqëndrueshëm dhe të trazuar në Kontinentin Evropian. Megjithatë, fundi i një dhune të shkallës të lartë nuk siguroi stabilitet afatgjatë në rajon. Elitat politike të tij kanë dëshmuar se nuk janë të afta apo nuk dëshirojnë të zgjidhin mospajtimet brenda tyre në mënyrë paqësore dhe të sigurojnë qetësinë e rajonit. Menaxhimi i problemeve më delikate në Ballkanin Perëndimor do të ishte siguruar më së miri në bazë të procesit të integritimit evropian. Me ndihmën e koordinuar të organizatave kyçe ndërkombëtare, Ballkani Perëndimor do të mund të shndërrohej në një rajon të sigurt, demokratik dhe të begatë.

Fjalët kyç: Ballkani Perëndimor, ballkanizimi, Kosova, siguria, komuniteti ndërkombëtar, KB, OSBE, BE, NATO.

Tendosjet e fundit politike në Kosovë, Serbi, Maqedoni, Bosnje & Hercegovinë, kanë tërhequr sërish vëmendjen e medieve dhe trupave të rëndësishme ndërkombëtare (KB, OSBE, BE, NATO). Qëllimi i këtij artikulli është t'i shpjegojë ndërlidhjet e shumëfishta në Ballkan, konfliktin potencial të tij, ndryshimet gjeopolitike në rajon dhe përreth, problemin kundërthënës të Kosovës, implikimet e tij ndërkombëtare dhe mësimet të cilat do të duhej të ishin marrë nga organizatat ndërkombëtare që janë marrë me Ballkanin Perëndimor të trazuar.

* Prof. dr. Anton Bebler, Fakulteti i Shkencave Sociale, Universiteti i Lubjanës, Slloveni, anton.bebler@fdv.uni-lj.si

Karakteristikat e përgjithshme të rajonit

Gjatë dy shekujve të kaluar, Ballkani Perëndimor ka merituar titullin e vendit më të paqëndrueshëm dhe shqetësues në Kontinentin Evropian. Gjatë shekullit XX konflikte të armatosura lokale dhe luftëra të koalicioneve me ndërlikim kontinental, terrorizëm, revoltë, revolucion, grusht shtet, dëbime masive të popujve, gjenocid i plotë dhe forma të tjera të dhunës, kanë trazuar pothuajse rregullisht periudhat e paqes në rajon. Pas katër dekadave relativisht të qeta filluan trazirat e fundit të përgjakshme, ku edhe pasuan luftërat e viteve 1990 - 1995 dhe 1998 - 1999.¹

Ballkani Perëndimor nga këto rritje të shpejta të ndryshimeve është ndezur, mirëpo gjatë kësaj periudhe kanë ndodhur edhe zhvillime pozitive - në fund të "luftës së ftohtë", rënia e regjimeve komuniste dhe transicioni i Evropës Lindore në sisteme politike më demokratike dhe tregti të lira. Ballkani Perëndimor ka treguar sërish ndjeshmëri të lartë ndaj ndryshimit të drejtpeshimit të fuqive ndërmjet aktorëve të mëdhenj jashtë rajonalë. Në këto aspekte, Ballkani është dukshëm i dallueshëm krahasuar me rajonet e tjera në Evropë, duke përfshirë pjesën veriore të Evropës Lindore. Jo rastësisht, vija e gabuar gjeopolitike, e cila shtrihet nga Evropa Juglindore, e drejtuar nga lindja në Oqeanin Paqësor, u potencua nga Z. Brzezinski në "Ballkani Euroaziatik".²

Paqëndrueshmëria gjeopolitike në Ballkan ka pasur rrënjë të thella politike. Gjatë më shumë se një mileniumi, inkursione të shumta, pushtime dhe migracione shkaktuan në Ballkan një përzierje unike dhe heterogjene të popujve dhe grupeve etnike me gjuhë dhe religjione të ndryshme.³

Evropa Juglindore bashkohet pjesërisht me rajonet e Mesdheut, Evropës Qendrore, Panonisë dhe Detit të Zi. Pjesa

¹ Blank, Stephen J. (ed.), *Yugoslavia's wars: the problem from hell*, Carlisle, Pa. Strategic Studies Institute, U.S. Army War College, 1995, Chapters 2,3,5,6.

² Zbigniew Brzezinski, *The Grand Chessboard*, Basic Books, 1997, New York, Chapter 3 'Euroasian Balkans', pp. 7-25,29-45,99-108.

³ Johnsen, William T. *Deciphering the Balkan enigma: Using History to Inform POLICY*, Carlisle, Pa, Strategic Studies Institute, U.S. Army War College, 1995, Chapters 2 in 3. Pp. 9-60.

qendrore e Evropës Lindore - Ballkani, ka qenë gjatë shekujve të tërë i ndarë ndërmjet disa perandorive me fuqi mbirajonale. Prandaj, Ballkani nuk ka mundur kurrë të bëhet rajon i suksesshëm dhe koherent në kuptimin kulturor, ekonomik ose politik. Emri i tij i sotëm u zbulua para tre shekujve e gjysmë nga të huajt (gjeografë gjermanë), të cilët përdorën gabimisht një fjalë turke për "bjeshkë". Pas katër shekujve të sundimit otoman dhe tërheqjes së tyre nga zotërimet në Evropën e mëparshme, Ballkani u bë një mozaik politik i komplikuar, të cilit i mungonte qendra e gravitetit. Shpërbërja e fundit e ish - Jugosllavisë në vitin 1991-1992, ka ngritur dukshëm numrin e shteteve në Ballkanin Perëndimor. Shpallja e Pavarësisë së Kosovës ka qenë zhvillimi i fundit në këtë drejtim. Megjithëse mundësia për ndarje politike të tjera në rajon nuk është zbehur në tërësi, pavarësisht nga mospranimi i përgjithshëm i Ballkanit nga Fuqitë e Mëdha, shtetet më të vogla, që kanë rezultuar nga ndarja, sot janë më pak heterogjene për sa u përket pikëpamjeve etnike, religjioze dhe kulturore në krahasim me ish - Jugosllavinë. Edhe Serbia, Kroacia, Kosova janë bërë më homogjene nga pikëpamja etnike dhe kulturore brenda kufijve të tyre. Ndryshimi dramatik, luftërat dhe zhvillimet e tjera prej viteve 1980, i kanë shkaktuar rajonit çrregullime dhe dëme të mëdha ekonomike.⁴ Ballkani Perëndimor ende nuk e ka arritur nivelin e prodhimit industrial dhe bujqësor të para viteve 1991. Në disa pjesë të rajonit, humbjet e luftës, çrregullimi i resurseve humane dhe natyrore, rënia e sistemeve të integruara të transportit dhe të energjisë, ndarja ekonomike dhe humbja e tregjeve, zhdukën rezultatet pozitive të tri dekadave të progresit ekonomik.

Dëmi jo i barabartë në ekonomitë e tyre ka ngritur dukshëm kontrastin ndërmjet pjesëve më të suksesshme dhe atyre më pak të suksesshme të rajonit. Diferencat ndër rajonale për sa i përket *GNP për kokë banori* dhe shkallës së papunësisë, janë ngritur frikshëm. Diferencat e mëdha brenda të njëjtit rajon shkaktojnë pa dashje trafikimin ilegal dhe krimin e organizuar.

⁴ Altmann, Franz-Lothar, "Regional economic problems and prospects" in the *Western Balkans: Moving on*, Chaillot Paper no. 70, Paris, Institute for Security Studies, 2004, p.p.69-84.

Supozohet, për shembull, që afër 8% e heroinës futet në zonën e Bashkësisë Evropiane nga Ballkani. Jo stabiliteti social, vështirësitë ekonomike dhe shqetësimi politik kanë kontribuar vazhdimisht në stereotipet negative nacionale dhe religjioze të krijuara dhe të mbajtura me sugjerimet e gjeneratave bazuar në mite historike.⁵ Tendosi ndërmjet etnike janë mbështetur nga ekzagjerimet e medieve masive moderne të manipuluar dhe të shfrytëzuara nga politikanët e paskrupull. Historia e traumatizuar e rajonit ka shërbyer si një mekanizëm i fuqishëm për mobilizimin masiv të parullave nacionaliste, religjioze dhe ksenofobe. Si rezultat i gjithë kësaj kanë ndodhur tragjeditë në Bosnje e Hercegovinë dhe në Kosovë.

Gjendja aktuale e sigurisë në Ballkan

Zhvendosjet tektonike, gjeopolitike në vitet 1990 dhe kriza e neutralizimit dhe mos grupimeve, kanë shkaktuar një rindërtim radikal politik dhe ushtarak në Ballkan si dhe në raportet e rajonit me fuqitë e jashtme. Me rënien e dukshme të ndikimit rus (dhe me eklipsin total të prezencës së politikës kineze në Shqipëri), i tërë rajoni u orientua praktikisht drejt Perëndimit. Meqë rajoni ka mungesë të madhe të mineraleve, energjisë dhe resurseve të tjera, rëndësia e tij gjeopolitike u zvogëlua relativisht. Përveç kësaj, Ballkani nuk është më objekt i hapur për grindje politike dhe kontroll ose zotërim ushtarak nga fuqitë e jashtme. Prandaj, dhe burimet e konflikteve në Ballkan, mbi dhe për të, janë reduktuar dukshëm.

Më e rëndësishmja është që Ballkani nuk është më fuqi baruti për Evropën, siç ishte në vitin 1914, por në vend të saj, ai ka fituar famë të keqe ndërkombëtare si një burim i shqetësimeve të vazhdueshme dhe trazirave të kushtueshme. Në anën tjetër, zhvendosjet gjeopolitike kanë minimizuar dukshëm motivacionin pozitiv të forcave të mëdha për t'i ofruar rajonit ndihmë ndërkombëtare.

⁵ Batt, Judy, *Introduction: "The stabilization/integration dilemma in The Western Balkans: Moving on*, Chaillot Paper no. 70, Paris, Institute for Security Studies, 2004, p.p. 7-19.

Që nga qershori i vitit 1999, një qetësi e jashtme mbretëroi mbi Ballkanin Perëndimor. Pas përpjekjeve të shumta të pasuksesshme nga KB, OSBE dhe BE,⁶ ky ndryshim i madh pozitiv u arrit kryesisht nga NATO. Pas hezitimeve të konsiderueshme, Forcat Perëndimore vendosën të ndërhynin politikisht dhe ushtarakisht në Ballkan. Fundi i konflikteve të armatosura në Kroaci, Bosnje e Hercegovinë, Serbi, Kosovë dhe Maqedoni, erdhi si pasojë e politikave të avancuara demokratike. Megjithatë, ky ndryshim politik vazhdoi të jetë kryesisht i cekët. Qetësia në rajon u mbajt deri në vitin 1996 nga disa *de facto* protektorate ndërkombëtare në disa pjesë të rajonit. Këto sisteme të vëzhgimit nga jashtë dhe ndihmave në disa vende kritike, kanë filluar stacionimin e trupave paqeruajtëse dhe stabilizuese të policëve ndërkombëtarë, të mbikëqyrësve të armatosur dhe të paarmatosur, të gjykatësve, të ombudspersonave, të kontrolluesve administrativë etj.

Siç është paraparë më herët, mbarimi i konkurrencës politike - ushtarake ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit në Ballkan, ka pasur, për sa i përket sigurisë, pasoja negative dhe pozitive. Ndalimi i dhunës së armatosur nga super fuqitë nuk e siguroi stabilitetin afatgjatë në rajon, siç u dëshmuua kohët e fundit në Kosovë, Serbi dhe Maqedoni. Çështja e sigurisë në Ballkanin Perëndimor mbeti akoma e pazgjidhur dhe ne vërejmë një kombinim të vjetër burimesh tensionimi e disa zhvillime të reja pozitive që nga viti 1990. Nën lustrën e qetësisë, disa probleme serioze politike dhe sigurie vazhdojnë të qëndrojnë në Ballkanin Perëndimor:

- prania e intolerancës, nacionalizmit patologjik dhe ksenofobisë;
- kultura e pazhvilluar demokratike-politike, mungesa e kompromiseve;
- shumëllojshmëria e kërcënimeve jo ushtarake mbi sigurinë rajonale dhe stabilitetin (qeverisja e keqe, korrupsioni, krimi i organizuar, trafik i ilegal i armëve, drogës dhe njerëzve etj.);

⁶ Burg.L. Steven, "Negotiating a settlement: lessons of the diplomatic process" in *Yugoslavia's Wars: The problem from hell*, 1995,p.p.47 -86.

- probleme të pazgjidhura të kufijve ndërshtetërorë dhe të minoriteteve;
- problemi humanitar i më shumë se një milion refugjatëve dhe personave të shpërngulur.

Shumë tentativa janë ndërmarrë në të kaluarën për të ndërtuar një rrjet rajonal sigurie në Ballkan. Këtu përfshihen dy marrëveshje mbrojtëse, njëra në vitin 1930 dhe tjetra në vitin 1950. Ajo e para dështoi mjerisht, kurse ajo e dyta – marrëveshja e Ballkanit ndërmjet Jugosllavisë, Greqisë dhe Turqisë e nënshkruar në gusht 1954- kurrë nuk u bë realitet. Deri tani asnjëra nga iniciativat dhe ndërmarrjet rajonale nuk është treguar e suksesshme, kryesisht për arsye se ato kurrë nuk janë mbështetur në aktivitetet politike të rajonit. Përveç kësaj, të gjitha iniciativave të Ballkanit u ka munguar zakonisht ndihma dhe pjesëmarrja publike e medieve masive si dhe ajo e shoqërisë civile.

Një tentativë më premtuese për të shëruar jostabilitetin në rajon u manifestua me orvatjet për të nxitur dhe ngjallur nga jashtë bashkëpunimin lidhur me ekonominë, politikën dhe sigurinë me Ballkanin dhe ndërmjet të gjitha shteteve të tij.⁷ Këto përpjekje kanë rezultuar që nga vitet 1980 në një rrjet të lidhjeve ndërmjet tyre dhe në mes tyre edhe të një numri të organizatave ndërkombëtare.

Ky rrjet ka qenë pothuajse tërësisht me prejardhje perëndimore, duke u përfshirë “Pakti i Stabilitetit”, CEFTA, SECI, “Partneriteti për Paqe” etj. Bashkimi Evropian e ka përkrahur dhe ndihmuar integrimin rajonal në Ballkanin Perëndimor duke nxjerrë disa lloje të bashkëpunimit, stabilizimit dhe marrëveshjeve shoqërore. Marrëveshjet kanë shërbyer si masa paraprake për t’i bashkuar dhe, eventualisht, për t’i lejuar të gjitha shtetet e mbetura të Ballkanit në radhën e anëtarëve të tij të ardhshëm. Kjo strategji e integritit u tregua e suksesshme në ushtrimin e saj mbi dy grupe të Evropës Lindore – grupi “Visegrad” dhe tri republikat Baltike.

⁷ Delevic, Milicia, “Regional cooperation in the Western Balkans”, Chaillot Paper no.104, Paris, Institute for Security Studies, 2007, Ch.2,3,pp.31-72.

Mirëpo, rrjetet, duke përfshirë shtetet e Ballkanit, kanë qenë kryesisht të varura nga donatorët e jashtëm të cilët nuk kishin personel të pamjaftueshëm, ishin të lidhur dhe të koordinuar dobët. Rrjedhimisht, vetëm disa prej tyre janë treguar të suksesshme. Përveç kësaj, disa nga këto rrjete kanë bllokuar pjesërisht njëri tjetrin. Kështu për shembull zgjerimi i BE-së ka ndaluar tregun e lirë dhe lëvizjen pa viza të njerëzve dhe, në fakt, ka krijuar barriera të reja ndërshtetërore në rajon. Rregulloret mbi vizat në BE dhe zgjerimi i regjimit *Shengen* ka krijuar probleme serioze në praktikë për arsye sepse kanë frenuar qarkullimin e njerëzve, bashkëpunimin ekonomik dhe kulturor në rajon. Ka pasur edhe një mospajtim konceptual në mes “Paktit të Stabilitetit për Evropën Juglindore” dhe “Procesit të Stabilizim – Asocimit”, drejtuar nga Bashkimi Evropian.

Problemi i Kosovës dhe implikimet e tij ndërkombëtare

Shpallja e pavarësisë së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe lindja e një shteti të ri evropian, kanë nxjerrë në relief një periudhë historike tendosjesh dhe konfliktesh në rajon.⁸

Në fundshekullin XIX dhe fillimshkullin XX, Kosova ka qenë një kapitull i vogël në çështjen e Shqipërisë brenda Perandorisë Otomane. Kosova, si një vend i veçantë dhe vazhdimisht i paqëndrueshëm, u formua në vitin 1912-1913 nga Mbretëria Serbe dhe Perandoria Ruse me ndihmën e disa shteteve të forta evropiane. Para vitit 1912, Serbia, Greqia dhe Mali i Zi kanë lidhur komplot me Mbretërinë Ruse për të ndërtuar një shtet të pavarur shqiptar mbi gërmadhat e posedimeve otomane në Ballkanin Perëndimor. Sipas planeve të tyre të koordinuara, që të tre shtetet ortodokse kanë okupuar dhe ndarë trojet me shumicë të popullatës shqiptare, për ta parandaluar deklaratën e pavarësisë së Shqipërisë. Si pasojë, ushtria serbe pushtoi Kosovën në vitin 1912, kur u nis për ta pushtuar edhe Shqipërinë Veriore dhe portin e saj kryesor,

⁸ Delevic, Milica, “The Kosovo problem in a regional perspective” in *The Regional cooperation in the Western Balkans*, Chaillot Paper no.10, Paris, Institute for Security Studies, 2007, p.p. 79 -82.

Durrësin. Mirëpo, plani i Serbisë për të fituar dalje të përhershme në Detin Mesdhe u pengua nga Austro-Hungaria dhe Italia. Në vitin 1913, pas një ultimatum austro-hungarez, ushtria serbe u tërhoq me ngurrim nga Shqipëria Veriore. Fuqitë evropiane – Britania e Madhe, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria dhe Italia i lejuan Serbisë dhe Malit të Zi mbajtjen e pjesëve lindore të okupuara nga pronat otomane të banuara kryesisht nga shqiptarët, myslimanët e tjerë dhe maqedonasit sllavë.⁹ Këto vende (Sanxhaku i Novi Pazarit, Kosova e sotme dhe Maqedonia Perëndimore) janë përvetësuar nga Serbia pa ndonjë proces të duhur të aneksimit. Posedimet e reja serbe u bashkuan në vitin 1918-1919 në Mbretërinë Serbe, Kroate dhe Sllovene,¹⁰ e cila u quajt më vonë Mbretëria e Jugosllavisë.

Në mes dy luftërave botërore, problemi i Kosovës ka qenë një çështje politike dhe sigurie destabilizuese, e cila kontribuoi në shpërbërjen e parë të Jugosllavisë në vitin 1941. Ajo vazhdoi të krijojë trazira të brendshme edhe në Jugosllavinë komuniste pas vitit 1945. Pas shpërbërjes së fundit në vitin 1991-1992, çështja e Kosovës u injorua tërësisht me vite të tëra nga komuniteti ndërkombëtar dhe u rishfaq në vitin 1997-1998 si një problem politik rajonal i pazgjidhur, si gjurmë e një vargu luftërash të Jugosllavisë. Çështja e Kosovës ishte, në thelb, një konflikt politik ndërmjet dëshirës së shqiptarëve të Kosovës për të qenë një shtet i emancipuar e me të drejtë vetëvendosjeje dhe, në anën tjetër, përpjekjeve të Serbisë për të vazhduar sundimin mbi këtë vend nga Beogradi. Për elitën kulturore dhe politike serbe, Kosova ka qenë një simbol i vlefshëm i triumfit të kaluar serb. Pas intervenimit nga NATO në Mars-Qershor 1999, sundimi serb mbi Kosovën përfundoi menjëherë. Paqja kurrë nuk do të arrihej në vend në mënyrë paqësore përderisa forcat luftarake, nën ndikimin e politikës aktuale në Evropë, do të vazhdonin të qëndronin në Kosovë. Një kompromis mbi autonominë e plotë të Kosovës brenda Serbisë u vendos në Kushtetutën e ish Jugosllavisë më 1974. Mirëpo ky kompromis

⁹ Kola, Paulin, *The search for greater Albania*, Hurst & Company, London, 2003, pp.10-18.

¹⁰ Noel, Malcolm, *Kosovo, A Short History*, London, Macmillan, 1998, pp.43-50, 61-63, 129-256, 289-294, 314-316.

historik u anulua nga regjimi i Milosheviqit më 1989. Ky akt brutal i njëanshëm nga Serbia, i shoqëruar nga tanket nëpër rrugët e Prishtinës, e theu tmerrësisht rregullin kushtetues të Jugosllavisë. Përveç kësaj, ushtria dhe policia serbe kreu qindra krime kundër shqiptarëve të Kosovës dhe myslimanëve të tjerë në Kosovë në vitet 1989-1999, duke përfshirë së paku 10.000 të vrarë. Sipas statistikave të UNHCR-it afro 350.000 persona, kryesisht shqiptarë, janë detyruar nga autoritetet serbe ta lëshojnë Kosovën në vitin 1998 dhe afro 1,5 milion në qershor 1999.¹¹

Që nga vera 1999 Kosova ka qenë një protektorat i NATO-s dhe kryesisht një vend vetëqeverisës nën mandatin e KB-së, tërësisht i ndarë dhe i pavarur nga Serbia.

Gjatë kësaj periudhe Kosova ka zhvilluar një sistem politik dhe ekonomik tjetër, si dhe ka pranuar një monedhë të ndryshme.¹² Gjatë këtyre viteve situata ekonomike, sociale, si dhe ajo politike në Kosovë, janë përmirësuar dukshëm. Ky progres u arrit me ndihmën ndërkombëtare (afër 21% GNP) dhe me para të dërguara nga jashtë në Kosovë (afërsisht 15% të GNP-së). GNP-ja në Kosovë u katërfishua në rreth 1000 Euro për person. Megjithatë, ajo është dy herë më vogël sesa në vendet fqinjë të Ballkanit, ku dhe mbizotëron varfëria (tek afër 45% të popullatës) si dhe papunësia e madhe (mbi 40% dhe afër 70% tek femrat dhe të rinjtë). Komuniteti Ndërkombëtar shpenzon rreth 2 miliardë euro në vit për aktivitetet e tij të rregullta në Kosovë, ndonëse shumicën prej tyre e shpenzon për mirëmbajtjen e sigurisë dhe për pagat e përfaqësuesve të vet. Vetëm një pjesë e vogël e këtyre fondeve (5-8%) derdhet direkt në ekonominë kosovare. Problemi i statusit të Kosovës u zgjodh me anën e një shpalljeje të njëanshme të pavarësisë, bazuar në miratimin e pashprehur të SHBA-ve dhe anëtarëve kryesorë të BE-së. Ky akt u krye, mirëpo pa vendimin e Këshillit të Sigurimit të KB-së për miratimin e Planit të Marti Ahtisaarit, por edhe pa ndëshkimin e KB-së, e sidomos pa anulimin e saj, siç kërkoi Serbia. Rekomandimet themelore të

¹¹ Kola, Paulin, *The search for greater Albania*, Hurst&Company, London, 2003, p.p.363.

¹² Altmann, Franz-Lothar, "The status of Kosovo" in *What status for Kosovo?*, Chaillot Paper no.50, Paris, Institute for Security Studies, 200, p.p.19-32.

M. Ahtisaarit (me mandatin e Sekretarit të Përgjithshëm të KB-së) janë zbatuar nga autoritetet kosovare të zgjedhura në mënyrë demokratike dhe me ndihmën e misionit të BE-së, i quajtur EULEX. Ky mision filloi punën më 15 qershor 2008 kur hyri në fuqi dhe kushtetuta e Kosovës. Legjitimiteti i saj u konfirmua nga Fuqitë Perëndimore bazuar në Rezolutën 1244 të Kombeve të Bashkuara dhe u sfidua nga Federata Ruse. Edhe pse mandati KB-së nuk ka përfunduar për shkak të mospajtimeve në Këshillin e Sigurimit, prezenca e UNMIK-ut, OSBE-së dhe NATO-s ka vazhduar nën këtë Rezolutë.

Problemi politik i Kosovës vazhdon të mbetet në agjendën e Evropës edhe për arsye të reperkusioneve të mëdha gjeopolitike të saj.

Sot Kosova përfaqëson vetëm një nga shumë konfliktet politike në botë, duke përfshirë këtu përçarjet etnike, nacionale, gjuhësore, kulturore si dhe religjioze brenda shteteve sovraane. Edhe në zonën Euro-Atlantike ekzistojnë këto probleme që nga Kebeku, Grenlanda, Skocia, Ulsteri, Katalonia dhe Krahina Baske në Spanjë, Belgjika, Korsika në Francë deri në Sllovakia, Estoni, Ukrainën Perëndimore, Bosnje e Hercegovinën, Maqedoninë Perëndimore, Moldavinë Lindore, Rusinë Jugore dhe Qipro. Më tej në Lindje janë vendet me trazira etnike, duke përfshirë këtu Abkhazinë dhe Osetinë Jugore në Gjeorgji, Nagorni Karabahun, Palestinën, Irakun Perëndimor. Ky varg i jostabilitetit politik shtrihet deri në Tibet, Tajvan, Sri Lankë, Filipine dhe Indonezi. Numri total i problemeve të ngjashme që kërcënojnë stabilitetin e shteteve shumetnike dhe religjioze në Afrikë, është gjithashtu i lartë. Secili nga këto konflikte është trajtuar (apo injoruar) veçmas nga komuniteti ndërkombëtar. Prandaj, edhe zgjidhja e statusit të Kosovës nuk duhet të krijojë një “domino-efekt” dhe të përsëritet diku tjetër. Nuk ka qenë e nevojshme që Federata Ruse ta përdorë njohjen e pavarësisë së Kosovës nga ana e Perëndimit si justifikim për njohjen e pavarësisë së Abkhazisë dhe Osetisë Jugore. Në të tre rastet që vetëm në disa aspekte kanë pasur zhvillime të ngjashme, Federata Ruse dhe shumica e vendeve anëtare të BE-së dhe NATO-s, kanë vepruar në mënyrë inkonsekuente, duke lejuar principin e vetëvendosjes në një rast dhe duke përjashtuar atë në raste të tjera. Që nga fundi i “Luftës së Ftohtë” ka pasur

ndryshime të shumta kufijsh të njohur ndërkombëtarisht në zonën Euro-Atlantike, në shumicën e rasteve pa miratimin e Këshillit të Sigurimit. Secili prej tyre - në Gjermani, ish-Jugosllavi, Çekoslllovakia dhe Bashkimin Sovjetik - mori drejtimin e vet.

Efektet politike të kufijve të ri kanë ndikuar pozitivisht në sigurinë evropiane. Duke u bazuar në situatën faktike që nga viti 1999, e njëjta gjë mund të pritet eventualisht edhe nga statusi i legalizuar i Kosovës në lidhje me Serbinë dhe me kufijtë e ri ndërshtetërorë mes Serbisë dhe Kosovës, pasi që raportet mes këtyre dy vendeve të jenë normalizuar.

Komuniteti Ndërkombëtar në ballafaqim me Ballkanin Perëndimor

Elitat politike në Ballkan kanë dëshmuar gjatë gjithë kohës që nuk janë të gatshme apo nuk mundin të arrijnë një konsensus mbi çështjet problematike me kompromis dhe komoditet të përbashkët. Ky fenomen fundamental u demonstrua p.sh. në konfliktin e gjatë Greko-Maqedonas mbi emrin kushtetues të Maqedonisë dhe në negociatat Serbo-Kosovare mbi statusin e Kosovës. Në rastet kur elitat e Ballkanit hyjnë në konflikte me fqinjët, zakonisht i ftojnë forcat nga jashtë për intervenime, në vend që të mundohen t'i zgjidhin problemet në mënyrë bilaterale, ose brenda një kornize rajonale. Kryesisht për këtë arsye, konfliktet e fundit në Ballkan kanë nxitur pjesëmarrjen e forcave ushtarake nga anëtarët e Këshillit të Sigurimit të KB-së (SHBA, Angli, Francë dhe Federata Ruse). Konfliktet në Ballkan kanë qenë gjithashtu në agjendat e KB-së OSBE-së, BE-së, NATO-s dhe në atë të Këshillit Evropian, duke kontribuar dukshëm në mosmarrëveshjet dhe antagonizmin ndërmjet Fuqive të Mëdha.¹³ Problemi i Kosovës ka shërbyer si një burim apo pretekst për tensionet ndërshtetërore kryesisht ndërmjet SHBA-së dhe anëtarëve të BE-së, Federatës Ruse dhe Serbisë.

¹³ Sophia, Clement, "The International Community response" in *Conflict Prevention in the Balkans*, (Chaillot Paper no.30), Paris, Institute for Security Studies, 1997, p.p. 46-74.

Problemi i Kosovës ka qenë një sfidë serioze për kohezionin e politikës së NATO-s në vitet 1998-1999. Aleanca ka mundur atëherë të zbuste dallimet ndër anëtarët e saj dhe të arrinte konsensus lidhur me ndërhyrjen e forcave ushtarake kundër Republikës Federative të Jugosllavisë në Mars 1999.

Nëntë vjet më vonë, çështja e statusit të Kosovës përçau BE-në dhe NATO-në përsëri. Shumica e anëtarëve të tyre kanë pranuar propozimin e Ahtisaarit që të njihet Pavarësia e Kosovës si një alternativë më e mirë. Një pakicë e anëtarëve të BE-së dhe NATO-s, saktësisht Greqia, Qiproja, Spanja, Sllovakia dhe Rumania iu kanë bashkëngjitur refuzimit të Serbisë. Mosmarrëveshjet ndërmjet anëtarëve të BE-së kanë qenë më të theksuara në vitin 2008 sesa ato në vitin 1991 lidhur me njohjen e pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë. Ky krahasim nuk është imazh i mirë për koherencën e politikës së jashtme dhe të sigurisë në BE pesëmbëdhjetë vjet pas fuqizimit të saj në vitin 1993. Të dhënat ndërkombëtare mbi burimet e lëkundjeve dhe të pasigurisë në Ballkanin Perëndimor kanë theksuar, në veçanti, nevojën e:

- kuptimit dhe vlerësimit real të komplikimeve të problemeve në Ballkanin Perëndimor dhe të parandalimit të zgjidhjeve njëdimensionale;
- ndërlidhjes, më herët të nënvlerësuar, të sigurisë në rajon me pjesët e tjera të kontinentit;
- veprimet robust ndërkombëtar të koordinuar mirë për të përmirësuar gjendjen ekonomike dhe sociale në vend dhe për të rregulluar e zhvilluar infrastrukturën e tij;
- kontributit të madh në menaxhimin e konflikteve dhe të stabilitetit në Ballkanin Perëndimor nga ana e anëtarëve të NATO-s dhe BE-së (Franca, Britania, Gjermania, Italia, Turqia, Greqia) dhe nga disa jo anëtarë, siç janë Federata Ruse dhe Ukraina;
- konsensusit fundamental ndërmjet Fuqive Perëndimore dhe punëve të koordinuara nga ata, posaçërisht ndërmjet SHBA-së dhe shteteve anëtare të BE-së;
- ndarjes racionale të punëve dhe koordinimit efektiv të vendimeve të marra ndërmjet Fuqive Ndërkombëtare të cilat merren me rajonin (KB, OSBE, NATO, BE, grupi i

kontaktit etj.), si dhe ndërmjet disa programeve të drejtuara nga organizatat e tyre;

- shmangies nga rreziku i një rrethi vicioz të varshmërisë në prezencën e paqeruajtësve të huaj (siç ka ndodhur në Qipro) dhe të miratimit të një strategjie realiste të daljes së tyre.

Këto synime janë relevante edhe për shtetin më të ri në Ballkan. Duke qenë një shtet i pavarur, Kosova duhet të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme të organizatave ndërkombëtare dhe rrjete rajonale ndërshtetërore të Ballkanit Perëndimor. Bashkëpunimi i Kosovës me këto grupe do të ketë efekte të dobishme për sigurinë e përgjithshme në Ballkan. Sa më shpejt që institucionet ballkanike të hyjnë dhe funksionojnë atje, aq më mirë është për rajonin dhe për tërë zonën Euro-Atlantike. Kooperimi për procesin evropian juglindor (SEECp), i mbështetur nga BE, është kujdesur për kooperimin e gjithanshëm ndërmjet shteteve të Ballkanit Perëndimor. Shpresojmë që edhe pasardhësi i tij, “Këshilli për kooperim rajonal”, me seli të sekretariatit në Sarajevë, do të vazhdojë të ketë suksese të lëndueshme. Të gjitha shtetet të cilat dëshirojnë të jenë anëtare të BE-së dhe/ose NATO-s, janë paralajmëruar që anëtarësimi i tyre në këto organizata do të jetë kusht që duhet plotësuar sipas obligimeve të tyre në rajon. Implementimi i këtij urdhri do të ndihmojë kooperimin rajonal.¹⁴ Duhet të jemi të kujdesshëm lidhur me sugjerimin, sipas të cilit menaxhimi i problemeve në Ballkan do të funksiononte më së miri brenda kornizave të integritimit evropian. Refuzimi i “Marrëveshjes Kushtetuese për një Evropë të re” nga votuesit francezë dhe holandezë, ka treguar kështu rezistencën e anëtarëve të mëparshëm ndaj zgjerimit të BE-së në Evropën Lindore dhe në Ballkan.

Prandaj, çështja e ashtuquajtur “mundësitë absorbuese” të BE-së duhet rishikuar nga një tjetër pikëpamje. Është pikëpyetje nëse BE do jetë i gatshëm dhe në gjendje të përmbushë

¹⁴ Van Meurs, Wim (ed.), *Prospects and Risks Beyond EU Enlargement, Southeastern Europe: Weak States and Strong International Support*, Opladen, Leske+Budrich, 2003, pp. 16-20.

marrëveshjet e Selanikut në shtetet e Ballkanit Perëndimor. Zvogëlimi dhe vonesa e dukshme e implementimit të këtyre marrëveshjeve nga BE, është bërë një mundësi e veçantë.

Përfundim

Rishikimi i problemeve të cekura më lart, në dhe përreth Ballkanit Perëndimor, shtron pyetjen, sesi t'i qasemi Ballkanit? Së pari duhet të frymëzohen shtetet e Ballkanit Perëndimor për t'i zhvilluar dhe forcuar lidhjet e tyre aktuale, dhe për të formuar rrjete pragmatike rajonale për bashkëpunim në çështje praktike. Në anën tjetër, nuk mund të presim nga shtetet e Ballkanit që t'i bëjnë ballë lëkundjeve aktuale vetëm me forcat e tyre. Elita e Ballkanit nuk është në gjendje të transformojë rajonin në një komunitet të suksesshëm dhe paqësor të vendeve, si Skandinavia, p. sh.

Aftësia e Bashkësisë Ndërkombëtare për të menaxhuar problemet e shumta në Ballkanin Perëndimor do të përmirësohej më së miri duke forcuar prezencën dhe ndikimin e BE-së dhe NATO-s në rajon. Ky zgjerim dhe mbindërtim do të duhej të bëhej në bashkëpunim me KB-në, OSBE-në, Këshillin e Evropës, Bankën Botërore etj. Po ashtu, prezenca e ushtrisë dhe policisë ndërkombëtare në disa pika neuralgjike (sidomos në Kosovë), do të jetë e domosdoshme për shumë vite. Transformimi cilësor i rajonit duhet të vihet në kontekst të gjerë të procesit të integritit evropian. Marrëveshjet për asocim dhe partneritet, si dhe për anëtarësim në BE dhe NATO, duhet t'u ofrohen të gjithë kandidatëve që e meritojnë dhe që aspirojnë, në mënyrë që të parandalohen linjat e reja të ndarjes në rajon.

Ky ka qenë objektivi kryesor i Sllovenisë gjatë presidencës së saj në Këshillin e BE-së, në pjesën e parë të vitit 2008. Gjatë këtyre gjashtë muajve ka pasur në fakt mjaft progres në këtë drejtim, përfshirë këtu edhe nënshkrimin e marrëveshjes për asocim-stabilizim me të gjitha vendet e rajonit, përveç Kosovës.

Procesi i zgjerimit të BE-së dhe NATO-s pritet ta shndërrojë Ballkanin Perëndimor në një hapësirë demokratike me ekonomi e kulturë dinamike dhe në një vend të sigurt dhe me prosperitet.

Bibliografi e zgjedhur

- Batt, Judy (ed.), *The Western Balkans: moving on* (Chaillot Paper no. 70), Paris, Institute for Security Studies, 2004.
- Batt, Judy, *The question of Serbia*, (Chaillot Paper no. 81), Paris, Institute for Security Studies, 2005.
- Batt, Judy (ed.), *Is there an Albanian question?*, (Chaillot Paper no. 107), Paris, Institute for Security Studies, 2008.
- Blank, Stephen J. (ed.), *Yugoslavia's wars: The problem from hell*, Carlisle, Pa, Strategic Studies Institute, U.S. Army War College, 1995.
- Clément, Sophia, *Conflict prevention in the Balkans: case studies of Kosovo and the FYR of Macedonia* (Chaillot Paper no. 30), Paris, Institute for Security Studies, 1997.
- Delevic, Milica, *Regional cooperation in the Western Balkans* (Chaillot Paper no. 104), Paris, Institute for Security Studies, 2007.
- Johnsen, William T., *Deciphering the Balkan enigma: Using History to Inform Policy*, Carlisle, Pa, Strategic Studies Institute, U.S. Army War College, 1995.
- Kola, Paulin, *The Search for Greater Albania*, London, Hurst & Company, 2003.
- Malcolm, Noel, *Kosovo, A Short History*, London, Macmillan, 1998.
- Rrecaj, Besfort T., *Kosovo's right to self-determination and statehood*, Pristina, 2006.
- Tindemans, Leo (Ch.), *Unfinished Peace, Report of the International Commission on the Balkans*, Aspen Institute, Berlin, 1996.
- Triantaphyllou, Dimitrios (ed.), *What status for Kosovo*, (Chaillot Paper no. 50), Paris, Institute for Security Studies, 2001.
- Van Meurs, Wim (ed.), *Prospects and Risks Beyond EU Enlargement, Southeastern Europe: Weak States and Strong International Support*, Opladen, Leske + Budrich, 2003.

Përktheu nga anglishtja Dafina Veza.

